



# Ridomil Gold<sup>®</sup>

## Plus 42.5 WP

<b>Lënda vepruese:</b>	Metalaxyl-M & Oksiklorur Bakri
<b>PËRMBAJTJA:</b>	Metalaxyl-M: 2.5% Bakër: 40% Lëndë ndihmëse: 57.5%
<b>Numri i regjistrimit:</b>	AL: 120/1,16.07.2010. KS: 087-0727-11-2007/05.03.2007
<b>Formulimi:</b>	Pluhur i lagshëm

## FUNGICID SPECIFIK, SISTEMI DHE KONTAKTI PËR KONTROLLIN E VRUGJEVE

**PËRDORIMI:** Përdoret në trajtimet parambrojtëse për luftimin e vrugjeve në:

**HARDHI** kundër *Plasmopara viticola* me dozë 400 gr/100 litra ujë. Kryhen 4 trajtime gjatë vegetacionit çdo 10 – 14 ditë.

**PATATE** kundër *Phytophthora spp*, me dozë 4 kg/ha. Maximumi 4 trajtime për sezon. Trajtimet përsëriten çdo 10 – 14 ditë.

**DOMATE** kundër *Phytophthora infestans* me dozë 500 gr/100 litra ujë. Trajtimet përsëriten çdo 7 – 10 ditë.

**MOLLË, QERSHI** dhe **PJESHKË** kundër *Phytophthora spp*. dhe *Pythium spp*. me dozë 100 -140 gr/pemë. Bëhen 2 trajtime tek molla e pjeshka dhe 3 trajtime tek qershia.

**AGRUME** kundër *Phytophthora spp* me dozë 100 -140 gr/pemë. Bëhen 2 trajtime për sezon.

**PERIME** dhe **BIMË TË ARAVE** kundër *Peronospora spp*, *Pseudoperonospora spp*, *Bremia spp*, me dozë 400 gr/100 litra ujë. Kryhen 3-4 trajtime gjatë vegetacionit. Trajtimet përsëriten çdo 10 – 14 ditë, ndërsa në perimet gjethore çdo 7-10 ditë.

**VËREJTJE:** RIDOMIL GOLD PLUS 42.5 WP ka efekt të pjesëshëm në sëmundjet që kontrollohen nga oksiklorur bakri si *Alternariozat*, *Septoriozat*, *Antraknozot*, *Sëmundjet bakteriale*, *Kladosporiozat* etj. Megjithatë, këto sëmundje nuk kontrollohen kur trajtimet kryhen çdo 10 – 14 ditë. Kur kushtet e motit favorizojnë këto sëmundje trajtimet të kryhen në interval 5 – 7 ditor.

**MËNYRA E PËRDORIMIT:** Me spërkatje.

**MËNYRA E PËRGATITJES SË TRETËSIRËS SPËRKATËSE:** Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit duke vazhduar përzierjen dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit.

**FITOTOKSICITETI:** Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara.

**PËRZIHET** me shumicën e fungicideve dhe insekticideve me reaksion neutral që përdoren në këto kultura.

**SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES:** Domate dhe Trangull 3 ditë, Perime të fam. Kryqore e Bulbore 7 ditë dhe në kulturat e tjera 14 ditë.

**PERIUDHA DHE KUSHTET E RUAJTJES:** 3 vjet. Preparati ruhet në kuti të mbyllura, në vende të thata e të ftohta. Evitoni ruajtjen në temperatura mbi 35° C. Preparati të mos mbahet në diell e në lagështi.

### MASAT PARAMBROJTËSE

-Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën. –Mbroni rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit. -Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse. -Pas pune duart dhe fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen. -Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni.

### UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me sytë ose lëkurën i lani menjëherë me ujë të bollshëm e sapun.  
-Në rast se merret me organet e frymëmarrjes nxirëni të aksidentuarin në vende të ajrosura. –Në rast qëllimshëm provokoni të vjellja dhe i bëni lavazh stomakut. Çojeni të aksidentuarin në spital dhe i treguni mjekut etiketën e produktit. Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik. Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



I dëmshëm nëse merret me organet e frymëmarrjes. Irritues për lëkurën.



### HELMUES PËR PESHQIT DHE PËR ORGANIZMAT UJORE.

Mos ndotni burimet ujore që përdoren për qëllime shtëpiake, ujitje etj. me mbeturinat e ambalazheve ose solucionin spërkatës.

**TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.**

**PRODHUESI:** SYNGENTA Crop Protection AG,  
Basel, Switzerland  
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax:+41 61 323 12 12